



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.282/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Majlinda Mehmeti, kandidate për Kuvendin Komunal në Podujevë të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

HEDHET e palejuar (pasafatshme) ankesa ZL.Anr.282/2025 e datës 20.10.2025 e parashtruar nga Majlinda Mehmeti, kandidate për Kuvendin Komunal në Podujevë e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.282/2025, të paraqitur nga Majlinda Mehmeti, kandidate për Kuvendin Komunal në Podujevë në të cilën thekson se bazuar në rezultatet e votuesve, të cilët me vullnet të plotë dhe pa presion janë deklaruar se janë votues të saj dhe konstatojn që votat për të nuk janë në kutitë e votimit. Parashtruesja e ankesës thekson se anat me shqetësim kanë përcjellë numërimin në QKN dhe kanë kërkuar që të paraqitet ankesë dhe të njëjtit janë të gatshëm të japin dëshmitë e tyre sepse në ditën e premte me datë 17.10.2025 kur është bërë edhe numërimi i votave në QKN në sistem të KQZ-së nuk janë vendosur votat e tyre. Parashtruesja e ankesës kërkon rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve në vendvotimet 1832/01 dhe 1832/02 Shkolla "Ali Ajeti", Ballofc dhe të vërë në dispozicion kopjet e procesverbaleve të numërimit, librit të nënshkrimeve dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, për shkak të dyshimeve të bazuara për mos-pasqyrim korrekt të votave të votuesve që kanë votuar për ankuesen në VV 1832/01 dhe 1832/02 kanë votuar votuesit e listuar në shtojcën 1 të kësaj ankese. E njëjta thekson se

nga rezultatet dhe procesverbalet paraprake të publikuara për këto VV, nuk pasqyrohet proporcionalisht numri i votave që këta votues deklarojnë se kanë dhënë.

Sipas parashtrueses së ankesës kjo krijon dyshim të arsyeshëm për gabime gjatë numërimit, shënimit ose transmetimit të të dhënave, prandaj rinumërimi dhe verifikimi i dokumentacionit janë masa të domosdoshme për garantimin e integritetit të votës dhe korrektesisë së rezultatit dhe kërkon urdhërim të rinumërimit të fletëvotimeve në VV 1 832/01 dhe VV 1 832/02 të QV 1832 - Shkolla "Ali Ajeti", Ballofë, vënien në dispozicion të kopjeve të procesverbaleve të numërimit për këto VV, librit të nënshkrimeve të votuesve, formularëve dhe çdo dokumenti tjetër përcjellës.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja thekson se procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahës fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga, KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 20.10.2025, ku ka pretenduar se në ditën e premte me datë 17.10.2025 kur është bërë edhe numërimi i votave në QKN në sistem të KQZ-së nuk janë vendosur votat e tyre.

Neni 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkëljes së supozuar”*.

Neni 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“Personi mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR,”*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

Në njoftimin e KQZ-së në web faqen e saj theksohet se *“deri më tani (e shtunë, ora 10:00), aktivitetet në Qendrat Komunale të Numërimit janë përmbyllur në 34 komuna, si: Hani i Elezit (e hënë 13 tetor), Junik, Mamushë, Zveçan, Ranillug, Partesh (e martë 14 tetor), Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Deçan, Shtime, Klinë, Shtërpçë, Obiliq, Istog, Skenderaj (e mërkurë 15 tetor), Viti, Rahovec, Suharekë, Dragash, Kaçanik, Lipjan, Fushë Kosovë, Ferizaj, Kamenicë, Drenas, Vushtrri (e enjte 16 tetor), Gjakovë, Graçanicë, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Pejë, Klllokot, Leposaviq (e premte 17 tetor), Gjilan, Malishevë, Prizren dhe Prishtinë (e shtunë 18 tetor)”*. Andaj nisur nga njoftimi i KQZ-së Paneli ka gjetur se me datën 17.10.2025 ditë e Premte janë përmbyllur aktivitetet në Qendrën Komunale të Numërimit në Podujevë.

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 17.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.282/2025 më datën 22.10.2025

Kryesuese e panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.